

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1



'Grupe serbe e greke që punojnë kundër Shqipërisë'/ Reagon Rama: Avash-avash të gjithë do dalin! Flamingot do habiten si ranë mes korbave e sorrave të shqiptarisë së rreme

2

Protesta para Kryeministrisë, moment tensioni mes organizatorëve! Reagime për përdhosjen e flamurit izraelit: Ka grupe të infiltruara, distancohemi!

3



Protesta në Tiranë/ Rama: Shqiptarët e Kosovës dhe Maqedonisë s'janë diasporë, por viktima, sponsorët po harxhojnë para për dëm kombëtar! Flamuri i UÇK u përdhos! Lëreni Kurtin jashtë kësaj çorbe

4

Momente tensioni me grupin e organizatorëve të protestës: Mos prek me dorë! (VIDEO)

5

Programi 'Pas shkolle' në shtator në 500 shkolla në të gjithë vendin, Ministria e Arsimit: Nxënësit do të vijojnë ta marrin ushqimin nga shtëpia

Kronikë

Sinjalizuan policinë për parcelat me drogë, dhunohen bashkëshortët në Fushë-Arrëz: U prezantuan si policë! Shoqërohet fqinji i dyshuar, në kërkim një tjetër

Denoncimi për parcelat me kanabis por dhe mbledhja e dredhëzave në mal, dyshohet se janë bërë shkak për një sherr të vazhdueshëm mes dy familjeve në Fushë-Arrëz. Sot pre e dhunës ka rënë çifti Skënder e Bardhe Nika, ndërsa autorët ende s'janë identifikuar. Në intervistë për Report TV ata dhanë se policia ka dijeni për konfliktet dhe nuk ka marrë asnjë masë.

■ I lënduari: Ishin 5 veta të maskuar! Njëri kishte automatik, të tjerët shkopinj gome

Bashkëshortët që u dhunuan para shtëpisë së tyre

Armir Mehaj
17 Qershor, 09:02 | **Përditesimi: 17 Qershor, 22:28**

Share Post

Bashkëshortët Skënder dhe Bardhe Nika nga fshati Arst i Fushë Arrzës u dhunuan mëngjesin e kësaj të mërkure nga disa persona të maskuar teksa kishin dalë jashtë banesës së tyre.

> *"Sot kam lënë punën rreth orës 6:00 dhe jam kthyer në shtëpi. Kur kam dalë pak jashtë shtëpisë, më kanë dalë përpara pesë-gjashtë veta të maskuar, me armë dhe me shkopinj. Kanë filluar të më rrahin. Nuk i kam njohur", thotë Skënder Nika.*

Nga shtrati i spitalit, 55-vjeçari rrëfen për Report TV se autorët u prezantuan si efektivë policie dhe pas sulmit ndaj tij, dhunuan dhe të shoqen me shkopinj gome e drunj.

> *"Më kanë thënë se janë policia dhe jam ulur në tokë. Njëri ka pasur automatikun, ndërsa tre-katër të tjerë kanë pasur shkopinj gome. Më kanë rrahur dhe janë larguar. Pastaj kanë shkuar në shtëpi. Kanë kapur në rrugë edhe gruan time", shprehet ai.*

Skënder Nika thotë se mosmarrëveshjet me fqinjin lidhen me kullotat dhe mbledhjen e dredhëzave në zonë. Ai shton se pak ditë para ngjarjes kishte pasur kërcënime.

> *"Ka pasur debate për dredhëza dhe për kullotat në malet tona. Madje na kanë thënë: 'Do ta shihni sherrin'. Dhe kjo ndodhi pas katër-pesë ditësh", thotë Nika.*

Por konfliktet mes palëve nuk janë të reja. Sipas 55-vjeçarit, katër vite më parë ai ishte akuzuar nga e njëjta familje se kishte denoncuar parcelat me kanabis, akuza që ai i mohon. Pikërisht në atë kohë, policia zhvilloi një operacion antidrogë në zonë, ku u asgjësuan tre parcela me bimë narkotike.

> *"Edhe ajo punë ka qenë problem. Në të vërtetë nuk ishim ne që i kishim denoncuar, por ata nuk u bindën. Na kanë bërë dëme dhe na kanë helmuar bagëtitë. Tek ata dyshoj. Nuk kam dyshime për njeri tjetër", Skënder Nika.*

Pas ngjarjes policia e Pukës dhe forcat Shqiponja të Shkodrës mësynë në familjen Balaj ku ushtruan kontrolle. Në komisariat shoqëruan Petrit Balajn dhe shpallën në kërkim anëtarin tjetër të familjes, Kristjan Balajn. Dyshohet se ky i fundit para tre ditësh i doli para me armë në pyll, familjes Nika. Hetimet për ngjarjen janë përqendruar tek konflikti për kanabisin.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 17:27

Dhuna ndaj bashkëshortëve në Fushë-Arrëz, shoqërohet në polici një anëtar i familjes Balaj, një tjetër shpallet në kërkim

Pas deklarimeve të çiftit të bashkëshortëve për dhunë nga familja Balaj, policia ka kontrolluar banesën e saj. 'Blutë' kanë shoqëruar Petrit Balajn dhe shpallur në kërkim Kristajn Balajn.

Ky i fundit dyshohet se para 3 ditësh i doli familjes Nika me armë në pyll.

Skënder dhe Bardhe Nika kanë deklaruar se i vetmi konflikt është me familjen Balaj.

P.J/Shqiptarja.com

Share

Ora 12:34

Dhunimi i çiftit në Fushë-Arrëz, i lënduari: Ishin 5 veta të maskuar! Njëri kishte automatik, të tjerët shkopinj gome

Dhunimi i çiftit në Fushë-Arrëz, i lënduari për Report Tv:
Report TV
REPORT TV HD
Watch on YouTube

Skënder Nika, pas dhunimit mëngjesin e sotëm pranë banesës ku jetonte (Arst) ka deklaruar për Report Tv se ishte duke u kthyer nga puna kur 5 persona të maskuar dhe me rroba të ngjashme me ato të RENEA-s e kanë ndaluar.

> *"Isha duke u kthyer nga puna nga HEC-i. Më kanë dalë pesë persona përpara dhe më thanë ndal Policia. Kam ndaluar ishin me maska dhe rroba të ngjashme me ato të RENEA-s. Njëri kishte automatik të tjerët shkopinj gome.*
>
> *Nuk di çfarë ka ndodhur vetëm më kanë qëlluar. Dhe di që më kanë thënë një herë mos bërtit pastaj ka dalë gruaja dhe e kanë rrahur dhe atë.*
>
> *Para katër ditësh kam pas një konflikt me një familje në fshat për dredhëza. Me të njëjtët kam pasur dhe 4 vite më parë, më kanë akuzuar se kam spiunuar.*
>
> *Kam kërkuar ti betohem e kam bërë çdo gjë që nuk kam paditur e spiunuar asnjë por nuk kanë pranuar. I vetmi konflikt ky është", thotë ai.*

Xh.K/Shqiptarja.com

Share

Xh.K/P.J/Shqiptarja.com

TAG: fushe arrez | Shkoder | Bardhe Nika | Skënder Nika

Komento

Komente

E sakt: 17/06/2026 19:34

Spiunimi esht nje ves i trasheguar nga komunizmi ose nga xhelozia per te tjeret,ma merr mendja se ky cift spiunash kan zen mend.

Përgjigju

Piro: 17/06/2026 12:43

Kjo është policia që kërkon informacion.

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH com

Sondazhi i ditës: 19 Qershor, 13:51

A kanë të drejtë SPAK dhe gjykatat të ndalojnë prezencën e kamerave gjatë seancave publike?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

SPECIALE/ Nga bankat e shkollës te kosheret në Pukë: Abdyl Arifaj dhe e vërteta mbi vështirësitë e bletarisë
Armir Mehaj
21 Qershor, 14:26

Qindra artdashës në Shirokë, Ramë Lahaj sjell mbrëmjen magjike të muzikës buzë liqenit
Ergys Kavaja
21 Qershor, 12:49

Nga mësimdhënia në fshat tek arti në Shkodër, Teuta Lagjja rrëfehet në 'Një nga ne': Bëj dy punë që të mbaj familjen
Xhensila Nako
20 Qershor, 15:53

Drejt plazhit e protestës! Fluks pushuesish për bregdet, makina 'kuqezi' për Tiranë (VIDEO)

Operacion antidrogë në Malësi të madhe, asgjësohen 306 bimë kanabis! Arrestohen 2



Deklaratat se u kërcënua nga Bajrat pas largimit nga PS, grupi kriminal i Shkodrës kallëzon

Botërori i Super Ofertave
ÇMIMI MË I MIRË 15.999 Lekë
-36% 24.999
Televizor Hoobart, 43 ", DVB-T2 / C, HDMI, USB, VGA, CI+, MPEG4, H.264.
Kodi: 810056
megatek Bëje mirë. Bëje vetë.